



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ardhur nëpërmjet postës elektronike, regjistruar me numër rendor 3 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 345 prot., datë 19.01.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 42 dhe 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në mbledhjen plenare të datës 18.01.2024 ka vendosur fillimin e procedurës së transferimit për gjyqtarët që aktualisht rezultojnë jashtë strukturës organizative të gjykatave ku janë të caktuar në mënyrë të përhershme. Konkretisht, lidhur me këtë pikë, Këshilli ka miratuar vendimet e mëposhtme:

1. Vendim nr.2, datë 18.01.2024 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”;
2. Vendim nr.3, datë 18.01.2024 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”;
3. Vendim nr.4, datë 18.01.2024 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”;
4. Vendim nr.5, datë 18.01.2024 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”;
5. Vendim nr.6, datë 18.01.2024 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”;
6. Vendim nr.7, datë 18.01.2024 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”;

Ndërsa, sa i përket projektvendimit “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit z. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”, ju informojmë se, Këshilli ka vendosur shtyrjen e shqyrtimit të tij deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 337, datë 18.01.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për gjyqtarin z. {...}.

Sa më sipër, bashkëlidhur shkresës gjeni vendimet e sipërcituara si dhe relacionin nr. 6309 prot., datë 07.12.2023 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicioneve në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme” (20 fletë gjithsej).

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!